

UDHËZIM
Nr.1, datë 12.01.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E VEPRIMTARIVE QË TRAJTOHEN SI VEPRIMTARI,
TREGTARE APO SHËRBIMI, AMBULANT SI DHE PROCEDURAT E
REGJISTRIMIT TË TYRE NË ORGANIN TATIMOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe kreut IV pika 1 paragrafi 2 dhe 3 i vendimit nr.167, datë 29.03.2006 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON

Të drejtën dhe detyrimin për t’u regjistruar si “persona të vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi, ambulant”, e kanë personat si më poshtë:

– Personat e vetëpunësuar, që kryejnë në mënyrë individuale tregti apo shërbime në lëvizje, të cilët nuk kanë vend qendrimi të përhershëm gjatë kohës së punës, si shitësit e akulloreve, të pijeve freskuese, të gazetave, revistave, të barnave, të zbukurimeve artistike, të veshmbathjeve, ilustraxhinjve etj., të kësaj natyre.

– Personat e vetëpunësuar, që kryejnë individuale dhe ambulante mbledhjen e mbeturinave të metaleve, të mbeturinave të qelqit, të letrës etj., të kësaj natyre, me qëllim shitjen për persona të regjistruar në organet tatimore.

– Personat e vetëpunësuar, që nxjerrin në mënyrë individuale dru zjarri, gurë mali etj., të kësaj natyre.

– Personat e vetëpunësuar, që kryejnë tregti apo shërbime individuale në tregjet e miratuara nga organet e qeverisjes vendore, të cilët kanë kontrata për zënie vendi me këto organe.

– Personat e vetëpunësuar, që kryesjnë në mënyrë individuale shërbime hidraulike, elektrike, shtrime pllakash, lyerje me bojë etj. të kësaj natyre.

– Personat e vetëpunësuar, që kryejnë individualisht punime me mjete motorike në bujqësi, të cilët, përveç plotësimit të nevojave familjare, kryejnë shërbime dhe për të tretë.

– Personat e vetëpunësuar, që kryejnë individualisht punime apo shërbime me mjete motorike dhe elektrike, ku përfshihen personat që disponojnë automjete, autotraktorë etj., mjete motorike e elektrike, me të cilat përveç plotësimit të nevojave familjare kryejnë dhe shërbime transporti udhëtarësh e mallrash apo punime e shërbime të ndryshme për të tretë, që nuk kanë vijueshmëri dhe kryhen me shkëputje gjatë javës.

Kur “personat e vetëpunësuar, në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante” janë edhe të vetëpunësuar në bujqësi do të sigurohen jo sit ë vetëpunësuar në bujqësi, por për veprimatrinë që kryejnë si ambulant.

Në të gjitha rastet “Personat e vetëpunësuar, në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante” janë të vetëpunësuar të vetëm dhe nuk kanë të drejtë të punësojnë persona të tjerë apo dhe punonjës të papaguar të familjes.

“Personat e vetëpunësuar, në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante”, regjistrohen në zyrën e taksave të njësisë së pushtetit vendor (bashkisë apo komunës), që kanë në juridiksion territorin ku është vendndodhja e biznesit, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Për sistemin e taksave vendore” dhe udhëzimit të përbashkët “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore.”

Veçori për këta tatimpagues është fakti se ata regjistrohen pa qënë nevoja për vendimin e gjykatës.

Dega e Tatimeve, brenda pesë ditëve pune nga mbërritja e listës zyrtare nga organet e pushtetit vendor, plotëson formularin e regjistrimit të tatimpaguesit me të gjitha të dhënat e kërkuara.

Brenda dy ditëve pas plotësimit të formularit të regjistrimit inspektori përkatës, nëpërmjet prtokollit të brendshëm e dërgon atë për regjistrim në sektorin përkatës së degës së Tatimeve. Ky i fundit bën regjistrimin e personit, plotëson certifikatën e regjistrimit me të dhënat përkatëse përfshirë edhe NIPT-in, të cilën ia dërgon zyrtarisht personit të tatueshëm (NIPT-i).

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisin personat për të cilët paguajnë contribute me numrin e sigurimit shoqëror (NSSH), të cilin e tërheqin nga organet e sigurimeve shoqërore.

Procedurat e pajisjes bëhen në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 29.03.2006, të ndryshuar dhe udhëzimit të Ministrit të Financave “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.”

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, zyrat e taksave (në bashki dhe komuna), si dhe organet në varësi të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan BODE